



VENDIM

Nr. 64 Datë 11.05.2015

PËR

LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “ELECTRAL” SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5 pika 2; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.05.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ELECTRAL” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “ELECTRAL” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “ELECTRAL” sh.p.k, në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike për një afat 5 – vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI